

Fort i Hirshem e idashur Im Ungj,

Nuk do t'ju shprehemja qe sot me kaq nxitim, po kam
 nja dy seshnje qe me shtyne. E para esht... seshnja e Z. Naçi; ku me
 tha qe, ne rrege ku u-pogme, se kish marre letren t' uaj dhe ate
 te Z. Joanidhi dhe esht xhindosur; m'a tregoj letren po e kam
 t' a kendojme me nje; me tha qe ka ka kenduar te tjereve dhe e
 gjen teper t' ashpër e kunders nigeris. Une i tregova gabimis qe beri
 dyke mos ardhur atje me kote dhe thashë qe kejo rodhi nga mos-ku-
 ptime dhe q' esht gje e papelqyer te mbije marica atje ku ka
 patur nigeris dhe armigeris. Fund' i fjales esht qe ay, sis me tha,
 do te vije atje te Marten qe vjen, po nuk do paraqitet te juve,
 ne gofte se mix e ftoni; ay do, ~~te~~ qe te mbyllet... konflikt; t'
 dergoni nje lajmerim te legra fishit, ku t' i thoni qe
 "Shkolla u-hap dhe nise te vish", ose, frendit t' i dergoni
 nje shenim t' atille kur te vije ne Korçe, ne hotel.

E dyta, esht nje letje qe kam per juve nga Z. Dr. Mihal Sherko,
 Drejtor i Shtypit ne Min. e P. te Jashtme. Ay ju dergon te fala dhe nde-
 rime dhe ju lutet qe t' i beni vend ne Seminarin (Internat)
 nje mikut ~~naçi~~ (gjellaxhi), shume te mire, qe ka sherbyer
 ne Rusi e ne Stamboll dhe ketu neper Legata e tani vdoohet me
 nje pune te vogel. Rastesisht kete njeri e njoh edhe une: qubet Hlam-
 bi Teli dhe esht nga Hoxishti; shume i mire do te jete per juve;
 perandaj, per kete bashkonj edhe une lutjen t' ime qe t' ia gjemi
 vendin dhe te na lajmeroni; keshtu do t' a kenajim Z. Sherko i cili
 me ka dhene perkrahje te madhe dhe po vashdon te me
 japë dhe, njekohesisht, i beni te mire nje bashkatdhetari qe
 esht i posaçem per ate pune.

Mbi keto urroj mbasnjajte per Shkollën Hieratike te
 vjere. — Paroje ju dergova Fletoren Zyrtare
 dhe Kalendarin t' em; besonj t' i kini marre. Tani




II

edhe dy fjale per punen t'ime. Kimi te drejte kur
sfugni lidherimin, por kam zene nje punë te sacete; kete
e ndjenj edhe une, po keshtu eshte uoha qe kam zene: ga-
zetarja, sidomos nder neve; kesh ka paze me shume
prokopsi. Me gjith ate mund te them se jam i vetmi
qe kam mundur te jetonj vetem me gazetari dhe me
shkrime kete. Tashi, qe u-hoga nga gazeta "Shtypsi",
eshte keq kur qendron me kape nje axhami - per miresova
punen, dhe rrogen me Zyren e Shtypit (te z. Sherko).
Duke patur kete mbeshketje po perpiqem t' a veshdori
edhe revisten t'ime "Kathen e Kritis", per te cilen me
kane dhune shpresa per perkrahje nga Beverra; po tashi
po e vashdoj vete; keto dit del. Per kete mund te me ndi-
hmoni edhe juve po te beni disa pajtime (oudroptias)
per djemt e Seminarit; mund te merrni 10 ose 20 copë;
pajtimi eshte 5 fr. ari ne vit dhe parapaguahet. Pas kesyre, me-
tonj qe te hap nje fare zyre te Revistes dhe bashke me nje shok
te ngre me nje fare Libraria te vogel, e cila mund te shoi-
llohet dal nga dal dhe mund te behet nje mbeshketje per
mu. Po per te filluar kete do me duhen nje 300 fr. ari per
kapital; mnx di, a mund t'a kem nga juve kete ndihme?!

Ime-shoze dhe femija jane mire dhe ju prarthim
doren. Tere nigue te fala.

Ketu brenda derzoj nje kart-vizite qe me ka
derguar ulla jemi me letren t'ime per juve, ka njaft
ditë.

Tirane, 22-I-1938



Ju prarth doren
me nderiq e dashur
Nipi juaj
Vasil

